



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT
JAVA 26
22 qershor – 28 qershor 2026

Për këtë javë, kanë raportuar 36 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) ose 100% (=36/36) e tyre.

Tabela 1. Plotësimi i formularit ALERT sipas çdo NJVKSH-je

Përqindja e plotësueshmërisë				
Rajoni	Qarku	Njvksh	Nr. Qendrave	%
TIRANË	Tiranë	Tiranë	35 / 35	100%
		Kavajë	10 / 10	100%
	Durrës	Durrës	20 / 20	100%
		Krujë	6 / 6	100%
	Dibër	Dibër	16 / 16	100%
		Mat	13 / 13	100%
		Bulqizë	9 / 9	100%
ELBASAN	Elbasan	Elbasan	28 / 28	100%
		Librazhd	11 / 12	92%
		Gramsh	8 / 8	100%
		Peqin	7 / 7	100%
	Korçë	Korçë	18 / 18	100%
		Pogradec	9 / 9	100%
		Devoll	6 / 6	100%
		Kolonjë	4 / 4	100%
	Berat	Berat	15 / 15	100%
		Kuçovë	4 / 4	100%
		Skrapar	7 / 7	100%
	Shkodër	Shkodër	19 / 19	100%

SHKODËR		M. Madhe	6 / 6	100%
		Pukë	11 / 11	100%
		Kukës	13 / 14	93%
	Kukës	Has	4 / 5	80%
		Tropojë	9 / 9	100%
		Lezhë	10 / 10	100%
	Lezhë	Kurbin	4 / 5	80%
		Mirditë	6 / 6	100%
VLORE	Vlorë	Vlorë	22 / 22	100%
		Sarandë	10 / 10	100%
		Delvinë	5 / 5	100%
	Fier	Fier	20 / 20	100%
		Lushnjë	18 / 18	100%
		Mallakastër	6 / 6	100%
	Gjirokastrë	Gjirokastrë	21 / 21	100%
		Përmet	8 / 8	100%
		Tepelenë	7 / 7	100%
		TOTAL	425 / 429	99%

Tabela 2. Numri Total i Rasteve të Sindromave të Survejancës “Alert” në Javën 26

	JAVA 26
Diarre pa gjak	2188
Diarre me gjak	0
Infeksione respiratore të sipërme	5849
Infeksione respiratore të poshtme	2042
Rash me temperaturë	16
Verdhëza	0
Ethe e zgjatur e pashpjeguar (> 3 javë)	0
Anomali kongenitale	0
Konjuktivit akut te neonatët	0
Numri i njësive raportuese	425
% e Njësive raportuese	99% (425/429)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog, rastet e mëposhtme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për variçelë:



Tiranë – 5 raste

Fier– 1 rast

Vlorë – 7 raste


Mat – 2 raste

Pogradec – 1 rast


Grafiku 1. Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas javëve.**Grafiku 2. Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas grup-moshave.**

Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet ulje në javën 25 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 26.

Grafiku 3. Trendi në kohë i diarreve pa gjak sipas javëve.




Grafiku 4. Shpërndarja e diarreve pa gjak sipas grup-moshave




Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet rritje në javën 26 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 25.

Grafiku 5. Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” në javët 20 – 26 të vitit 2025 dhe vitit 2026. Numri i rasteve.




Në javën 26 të vitit 2026 vërehet një ulje e numrit të Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme.


Grafiku 6. Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000).



Grafiku 7. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas NJVKSH-ve në javën 25/2026 dhe 26/ 2026. Incidenca (raste/10.000).




Vërehet një rritje e lehtë e infeksioneve respiratore në disa NJVKSH, ndërsa aktiviteti i gripit mbetet në nivel të ulët sezonal.

Grafiku 8. Prirja e “Diarreve pa gjak” në javët 20-26 të vitit 2025 dhe 2026. Numri i rasteve.

Në javën 26 vërehet prirje në rritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”, këtë vit vërehet një numër më i ulët i këtyre infeksioneve, krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 9. Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH-ve në javën 25-26 2026 Incidenca (raste/10.000).



Vërehet një rritje e rasteve me diarre, veçanërisht në NJVKSH Vlorë, Tropojë dhe Sarandë, ku situata po monitorohet në mënyrë të vazhdueshme. Kjo rritje lidhet edhe me faktorët sezonalë dhe lëvizjet më të shpeshta të popullsisë gjatë sezonit veror, si dhe me raportimin e qendrave verore në sistem.

Ngjarje ndërkombëtare

Shpërthimi i sëmundjes Ebola të shkaktuar nga virusi Bundibugyo – Republika Demokratike e Kongos dhe Uganda – 2026.

- Deri më 26 qershor 2026, në Republikën Demokratike të Kongos janë raportuar gjithsej 1155 raste të konfirmuara, përfshirë 304 vdekje të konfirmuara të lidhura me shpërthimin, në provincat Ituri, Kivu Veriore dhe Kivu Jugore. Gjatë 24 orëve të mëparshme janë raportuar 37 raste të reja dhe pesë vdekje të reja. **Në Uganda janë raportuar gjithsej 20 raste të konfirmuara, përfshirë dy vdekje.**
- **Më 24 qershor 2026, Ministria e Shëndetësisë në Francë raportoi rastin e parë të identifikuar të sëmundjes nga virusi Ebola te një mjek humanitar që ishte kthyer nga një mision në Republikën Demokratike të Kongos. Rasti është vendosur në izolim dhe ka nisur gjurmimi i kontakteve. Deri tani janë identifikuar dhe vendosur në izolim pesë kontakte.**
- **Organizata Botërore e Shëndetësisë publikoi më 19 qershor 2026 një raport “Disease Outbreak News”, ku vlerësimi i rrezikut nga OBSH ishte: shumë i lartë për Republikën Demokratike të Kongos, i lartë për Ugandën dhe i lartë për vendet ngjitur me kufij tokësorë. Rreziku për pjesën tjetër të rajonit të Afrikës dhe në nivel global u vlerësua si i ulët.**
- Më 17 maj 2026, OBSH deklaroi se shpërthimi i sëmundjes Ebola për shkak të virusit Bundibugyo përbënte një Emergjencë të Shëndetit Publik me Rëndësi Ndërkombëtare. Më 18 maj 2026, Africa CDC shpalli një Emergjencë të Shëndetit Publik për Sigurinë Kontinentale.
- Duke marrë parasysh të gjithë informacionin e disponueshëm dhe pasiguritë lidhur me këtë shpërthim, probabiliteti i infektimit për personat nga Shqipëria dhe BE që jetojnë ose udhëtojnë në zonat e prekura vlerësohet si i ulët. **Për personat që jetojnë në Shqipëri dhe Bashkimin Evropian/Zonën Ekonomike Evropiane, probabiliteti i infektimit vlerësohet si shumë i ulët, duke pasur parasysh probabilitetin shumë të ulët të importimit dhe transmetimit dytësor. Ky vlerësim do të rishikohet me daljen e informacioneve të reja.**
- ISHP po monitoron shpërthimin përmes aktiviteteve të inteligjencës epidemike dhe të dhënat nga ECDC dhe OBSH.

Survejanca sezonale e infeksioneve nga Virusi i Nilit Perëndimor – 2026, raport javor

- Në Evropë, që nga fillimi i vitit 2026 dhe deri më 24 qershor, dy vende kanë raportuar tre raste njerëzore të infeksionit nga Virusi i Nilit Perëndimor: Italia dhe Maqedonia e Veriut.

Survejanca sezonale e etheve hemorragjike Krime-Kongo – 2026, raport javor

- Që nga fillimi i vitit 2026 dhe deri më 24 qershor 2026, një vend në Evropë ka raportuar raste të fituara lokalisht të etheve hemorragjike Krime-Kongo: Spanja, me një rast.

Rastet e Ethes Dengue 2025–2026

- Pas një kulmi të rasteve të sëmundjes të lidhura me udhëtime nga Maldivet në fund të vitit 2025 dhe në fillim të vitit 2026, disa vende të BE kanë raportuar së fundmi rënie të rasteve të dengës të lidhura me udhëtimet në Maldivë.

- Kushtet mjedisore në shumicën e zonave të BE ku janë të pranishëm vektorët e virusit të dengës, *Aedes albopictus* ose *Aedes aegypti*, janë tashmë të favorshme për aktivitetin e mushkonjave dhe replikimin e virusit të mushkonjat. Prandaj, në javët në vijim mund të shfaqen raste të dengës të fituara lokalisht pas futjes së virusit nga udhëtarë që kthehen nga zonat e prekura.
- Përpjekjet e shëndetit publik duhet të fokusohen në komunikimin me udhëtarët dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor.

Sëmundja nga virusi chikungunya e lidhur me udhëtimet në vendet e BE/EEA e importuar nga Seychelles

- Deri në qershor 2026, disa vende të BE/EEA raportuan më pak raste të importuara të chikungunya-s krahasuar me periudhën nëntor 2025 – prill 2026, me fillimin më të fundit të simptomave në mes të majit.
- Kushtet mjedisore në shumicën e zonave të BE/ZEE ku janë të pranishëm vektorët e virusit chikungunya, *Aedes albopictus* ose *Aedes aegypti*, janë tashmë të favorshme për aktivitetin e mushkonjave dhe replikimin e virusit të mushkonjat. Prandaj, në javët në vijim mund të shfaqen raste të sëmundjes nga virusi chikungunya të fituara lokalisht pas futjes së virusit nga udhëtarë që kthehen nga zonat e prekura.
- Udhëtarët duhet të këshillohen të zbatojnë masa për parandalimin e pickimeve nga mushkonjat. Vaksinimi mund të merret në konsideratë në përputhje me rekomandimet kombëtare.

Mpox në BE/EEA, Ballkanin Perëndimor dhe Turqi – 2026

- Në maj 2026, 94 raste të Mpox të shkaktuara nga virusi monkeypox, grupimi I, u raportuan nga 12 vende të BE/EEA, duke treguar një ngadalësim të mundshëm pas rritjes së vërejtur më herët gjatë vitit 2026. Në të njëjtën periudhë, 22 raste të Mpox të shkaktuara nga grupimi II u raportuan nga gjashtë vende, duke vazhduar një pritje në rënie.
- Transmetimi për të dyja grupimet ndodh kryesisht brenda rrjeteve të burrave që kryejnë marrëdhënie seksuale me burra, me qarkullim të vazhdueshëm në BE/ZEE dhe me shumicën e rasteve të raportuara tek individët e pavaksinuar.
- **Ashpërsia e sëmundjes mbetet përgjithësisht e lehtë, me norma të ulëta hospitalizimi për të dyja grupimet.**
- **Me fillimin e sezonit pranverë-verë dhe rritjen e udhëtimeve dhe grumbullimeve masive, ekziston rreziku për përhapje të mëtejshme.**

Përmbledhje e epidemiologjisë së viruseve respiratore në BE/EEA

Aktiviteti i viruseve respiratore në të gjithë BE/EEA është në nivele të ulëta, duke treguar qarkullim të kufizuar të viruseve respiratore. **Aktiviteti i SARS-CoV-2 në të gjitha grup-moshat, në kujdesin parësor dhe dytësor mbetet i ulët. Aktiviteti i virusit respirator sincicial, RSV, është në nivele ndërsezonale. Aktiviteti i virusit të gripit është në nivele ndërsezonale.**

Gripi i shpendëve A(H9N2) – monitorimi i rasteve në njerëz

- **Më 23 qershor 2026, një rast i ri njerëzor i gripit të shpendëve A(H9N2) u raportua në Rajonin Autonom Guangxi Zhuang në Kinë.**

- Rasti i përket një fëmije, me fillim të sëmundjes më 31 maj 2026.
- Rreziku për shëndetin e njeriut në Shqipëri dhe Europë konsiderohet shumë i ulët.

Kolera – monitorimi i shpërthimeve globale, përditësim mujor

- Që nga 1 janari 2026 dhe deri më 22 qershor 2026, në nivel botëror janë raportuar 105 813 raste kolere, përfshirë 1 216 vdekje.
- Që nga 26 maji 2026 dhe deri më 22 qershor 2026, në nivel botëror janë raportuar 19 659 raste të reja kolere, përfshirë 261 vdekje të reja.
- Pesë vendet që raportojnë më shumë raste janë Nigeria me 8 051 raste, Republika Demokratike e Kongos me 7 923 raste, Angola me 1 930 raste, Malawi me 882 raste dhe Burundi me 358 raste.
- Pesë vendet që raportojnë më shumë vdekje të reja janë Republika Demokratike e Kongos me 112 vdekje, Nigeria me 77, Angola me 42, Kongo me 27 dhe Mozambiku me 2.
- Gjithashtu, më 23 qershor 2026, Qendrat për Kontrollin e Sëmundjeve në Tajvan raportuan një rast kolerë të fituar lokalisht te një grua në të 70-at, pa histori të fundit udhëtimi. Pacientja u shtrua në spital dhe, pas trajtimit gjendja e saj u përmirësua gjë që bëri të dilte nga spitali.
- Rastet e kolerës kanë vazhduar të raportohen në Afrikë, Azi, Lindjen e Mesme dhe në Amerikë. Rreziku i infeksionit nga kolera për udhëtarët që vizitojnë këto vende mbetet i ulët, megjithëse importimi sporadik i rasteve në Europë është i mundshëm.